



Agjencia e Akreditimit e Kosovës
Kosovo Accreditation Agency
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel : +381 38 213-722
Fax:: +381 38 213-990
e-mail: kaaoffice@gmail.com
web: www.akreditimi-ks.org

Nr. 476/12 dt. 09.07.2012

Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7, pika 2.3 dhe pika 4, Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat te Arsimit të Lartë (Nr 14/2003), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr.11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 09/2012), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (nr. 12/ 2009), në mbledhjen e mbajtur më 06 Korrik 2012 ka marr këtë:

V E N D I M

I. Akreditohen programet e studimit të Kolegjit Evropian “Dukagjini”:

- Shkenca Kompjuterike dhe TI (BSc)
- Ekonomi, Banka, Financa dhe Kontabilitet (BA)

për periudhë 3 vjeçare, 1 Tetor 2012-30 Shtator 2015.

II. Programet e Studimit:

- Menaxhment dhe Informatikë (BSc)
- Juridik (LLB)

akreditohen për periudhë 1 vjeçare, 1 Tetor 2012-30 Shtator 2013.

III. Programet e Studimit:

- Shkenca Politike dhe Gazetari (BSc)
- Menaxhment (MSc)

Nuk akreditohen.

IV. Institucioni i juaj është i obliguar që të harton një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët dhe në të dy versionet) dhe të njëjtin ta dorëzoni në AKA gjër më 1 Nëntor 2012.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.


Dr.sc. Ferdije Etemi-Zhushi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë